



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 30, datë 27.02.2025.

PËR
“CAKTIMIN E ZOTIT PLATIN ALIÇKA, NË DETYRËN E PROKURORIT NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, NËPËRMJET PROCEDURËS SË
LËVIZJES PARALELE”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), me pjesëmarrjen e:

| | |
|--------------------------|----------------------|
| 1. Zonjës Mirela BOGDANI | Kryetar (në mungesë) |
| 2. Zotit Erind GERMENJI | Zv/Kryetar |
| 3. Zotit Sokol STOJANI | Anëtar |
| 4. Zotit Zeqir HODA | Anëtar (në mungesë) |
| 5. Zonjës Arta MANDRO | Anëtar (në mungesë) |
| 6. Zonjës Ledina RIZA | Anëtar |
| 7. Zotit Moisi DUDA | Anëtar |
| 8. Zotit Vatë STAKA | Anëtar (në mungesë) |
| 9. Zotit Olger EMINAJ | Anëtar |
| 10. Zotit Erind MERKURI | Anëtar |
| 11. Zotit Erion FEJZULLA | Anëtar |

në mbledhjen e datës 27.02.2025, konform procedurës së përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Caktimin e zotit Platin Aliçka, në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim, relacioni shoqërues nr. 390 prot., datë 26.02.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi relatorin zotin Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

VËREN:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.
2. Këshilli me vendim nr. 332, datë 19.12.2022, “Për shpalljen e pesë vendeve vakante për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”, ka shpallur 5 (pesë) vende vakante në këtë Prokurori, të cilat do të plotësoheshin nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.
3. Lidhur me njërin prej pozicioneve vakante në fjalë dhe konkretisht për pozicionin e emërtuar me numrin 4, u kualifikuan 4 kandidatë, të cilët me vendimin e Këshillit nr. 96, datë 09.05.2023, “Për renditjen e kandidatëve për pozicionin vakant nr.4 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, u renditën si më poshtë:
 1. Platin Aliçka
 2. Xhelian Seferi
 3. Edlira Bako
 4. Aida Cakaj
4. Pcedura ka vijuar me vendimin e Këshillit nr. 125, datë 29.05.2023, “Për caktimin e zotit Platin Aliçka në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”, duke bërë caktimin në detyrë të prokurorit të renditur i pari, bazuar dhe në përmbushje të përcaktimeve ligjore sipas në nenin 41, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
5. Procedurat më lart, janë ankimuar gjyqësisht nga kandidatja znj. Edlira Bako. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. 33 (86-2023-663), ka vendosur detyrimin e Këshillit të shfuqizojë vendimin nr. 96, datë 09.05.2023 “Për renditjen e kandidatëve për pozicionin vakant nr.4 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.
6. Në këto kushte, Këshilli me vendimin nr. 20, datë 07.03.2024, “Për shfuqizimin e vendimeve nr. 96, datë 09.05.2023 dhe nr. 125, datë 29.05.2023”, ka shfuqizuar këto dy vendime. Me vendimin nr. 21, datë 07.03.2024, ka caktuar përkohësisht zotin Platin Aliçka

në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

7. Më tej, Këshilli ka vijuar me vendimet nr. 72, datë 10.06.2024, nr. 191 datë 09.09.2024 dhe nr. 259 datë 10.12.2024, duke caktuar përkohësisht për një afat tre mujor zotin Platin Aliçka, në detyrën e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë., ndërkohë që së fundi afati i caktimit të përkohshëm të prokurorit Aliçka përfundon në datë 09.03.2025.

Për sa më sipër Këshilli vlerëson se:

8. Lidhur me çështjen e kundërshtuar gjyqësisht Gjykata e Lartë ka publikuar¹, njoftimin për çështjen së bashku me dispozitivin e vendimit si më poshtë:

- Nr. Akti 31001-00401-00-2023;
- Me palë ndërgjyqëse: Edlira Bako kundër KPL-së, Platin Aliçka, Xhelian Seferi, Aida Cakaj dhe Avokatura e Shtetit;
- Me objekt: Shfuqizimi i vendimit nr. 96, date 09.05.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- “Për renditjen e kandidatëve për pozicionin vakant nr. 4 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpallur me vendimin nr.332 datë 19.12.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”. Detyrimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë që në renditjen e kandidatëve për vendin vakant nr.4, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të respektojë rregullimet ligjore të parashikuara në nenin 43,53/9 të Ligjit 96/2016 dhe nenit 26/3 të Regullores “Për procedurën e lëvizjes paralele të prokurorëve”, ndryshuar me vendimin nr. 240, datë 29.9.2022, të KLP- së duke më renditur të parën në listën e kandidatëve për vendin vakant me nr. 4.
- Me dispozitiv: Ndryshimin e vendimit nr.33, datë 13.06.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe rrëzimin e padisë.

9. Sa më sipër Gjykata e Lartë përfundimisht ka rrëzuar padinë duke lënë fuqi vendimin e Këshillit nr. 96, datë 09.05.2023, “Për renditjen e kandidatëve për pozicionin vakant nr. 4 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, ndërkohë që ka rrëzuar gjithashtu kërkesën e paditëses për ta renditur të parën në listën e kandidatëve për vendin vakant Nr. 4, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpallur me vendimin nr. 332 datë 19.12.2022.

¹ Link: gjykataelarte.gov.al/sq/lajme/publiku/informacion-i-ceshtjeve-administrative-date-18.09.2024

10. Në këto kushte, Këshilli vlerëson se tashmë nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për të vijuar me caktimin në detyrë² të zotit Platin Aliçka në detyrën e prokurorit, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës, nenin 90, pika 2 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenin 41 dhe 43 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164, pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 44 dhe 45 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, vendimit nr. Akti 31001-00401-00-2023, të Gjykatës së Lartë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Caktimin e zotit Platin Aliçka në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionin vakant Nr. 4 shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. 332, datë 19.12.2022.
2. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Platin Aliçka, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 27.02.2025

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla

² Vendimi i Gjykatës së Lartë është shpallur në datë 18.09.2024, dhe nga ana e Komisionit dhe e Këshillit (sipas vendimeve të sipërcituara), është vlerësuar që zoti Platin Aliçka të caktohet në zyrën e prokurorisë Tiranë, nëpërmjet mjetit ligjor “caktim i përkohshëm” deri në zbardhjen e vendimit. Duke qenë se, vendimi i datës 18.09.2024, ende nuk është zbardhur, por në faqen zyrtare ëeb të Gjykata e Lartë është publikuar dispozitivi i tij, Komisioni vlerësoi të vijojë procedurat në bazë të tij.